

Anastas ANGJELI\*, Ilir HEBOVIJA\*

## LIQENI I SHKODRËS PREMISAT PËR NJË MODEL TË SUKSESSHËM ZHVILLIMI

**Përmbledhje:** Transformimi i Liqenit të Shkodrës, një model i zhvillimit të suksesshëm të këtij koncepti nëpërmjet zhvillimit dhe lidhjes së tij kërkon një model zhvillimi që përfshin ndërveprimin ekonomik dhe ekologjik, infrastrukturën atraktive turistike dhe transportuese, peshkimin, biznesin dhe shërbimet sociale: (i) Ndërtimi i një strategjie të përbashkët, projekte të zhvillimit ekonomik dhe mosndarje të zonave të ndikimit, por përcaktim i prioriteteve dhe bashkëpunimit; (ii) Aktivitet ekonomik i orientuar drejt shërbimit vetëm nëpërmjet zhvillimit të turizmit të liqenit, aktiviteteve të biznesit dhe mbështetjes së nëndegëve, peshkim, transport, etj.; (iii) Zhvillimi i infrastrukturës jo vetëm në afërsi të qytetit, por edhe në të gjithë hapësirën ku liqeni lidh të dy anët e kufirit; (iv) Shfrytëzimi dhe përmirësimi i të gjithë burimeve të disponueshme; (v) Programet e implementimit përmes një bashkëpunimi të ngushtë të sektorëve publikë dhe privatë.

**Fjalë kyçe:** *strategji e përbashkët, projekte të zhvillimit ekonomik, infrastruktura, burime të disponueshme, sektorët publikë dhe privatë*

**Abstract:** Transformation of Lake Shkodra, a model of successful development of this conception through development and his connection as a common development model, economic and ecological interaction, attractive tourist-and-transport infrastructure, fishing, business and social services; (i) Building a joint strategy, economic development projects and not to separate areas of influence but to set priorities and cooperation; (ii) Oriented economic activity in the service only through the development of lake tourism, business activities and supporting its subsidiary, fisheries, transport, etc.; (iii) Infrastructure development not only in the vicinity of the city but in the whole space where the lake lies on both sides of the border; (iv) Exploitation and improvement of all available resources; (v) Implementation programs through a close collaboration of public and private sectors.

**Key words:** *joint strategy, economic development projects, infrastructure, available resources, public and private sectors*

---

\* Anastas Angjeli, Ilir Hebovija, Universiteti Mesdhetar i Shqipërisë

## HYRJE

Sfida e përballjes me pasojat e ndryshimeve klimaterike globale (provat shkencore se klima dhe mjedisi po ndryshojnë, janë shtuar aq shumë dhe po shtohen vazhdimisht, duke u shndërruar në epiqendër të diskutimeve globale) dhe të krizës ekonomike globale, kanë zhvilluar më tej mendimin ekonomik, shkencor e akademik dhe po i japin një shtysë të re politikave ekonomike e financiare dhe ambientaliste globale. Në këtë kontekst, një vend dhe rol të rëndësishëm po luan edhe „shkolla e mendimit të zhvillimit ekonomik të gjelbër” (Green Economy), e cila, tashmë, nga një mendim akademik e shkencor, po shndërrohet në platforma e programe qeverisëse në disa vende, duke pretenduar të bëhet pjesë e rëndësishme dhe dominuese e politikave ekonomike globale.

Kjo është intensifikuar edhe më shumë, pas hyrjes në fuqi, pesë vjet më parë të protokollit të Kiotos dhe sidomos një shtysë edhe më të madhe mori vitin e kaluar me zhvillimin e Konferencës së Kombeve të Bashkuara për ndryshimet klimaterike në Kopenhagen. Fakti që në këtë samit morën pjesë vendet të cilat përbëjnë 82% të gjithë popullsisë botërore, si dhe 89% të GDP botërore, liderët, politikanët dhe drejtuesit më të lartë të shteteve pjesëmarrëse, mbi 15 mijë shkencëtarë e studiues analistë, ekonomistë, ambientalistë, nxori në pah vlerën dhe rëndësinë e këtij problemi.

Në këtë kontekst, shkencëtarët kanë filluar të sugjerojnë se kemi arritur në pikën ku duhet bërë kthesa. Bill Mckibben e ka shprehur këtë si më poshtë: „Ne nuk mundemi më ta mendojmë veten si pjesë të diçkaje që është më e madhe se vetë ne, tani jemi ne që e bëjmë botën, ne influencojmë çdo veprim”. Njerëzimi ka folur gjithmonë për kalimin nga „adaptimi” me natyrën, në „menaxhimin” e saj.

## ÇFARË DUHET TË BËJMË PËR NJË ZHVILLIM EKONOMIK TË GJELBËR?

Zhvillimi ekonomik i gjelbër presupozon një lloj të ri zhvillimi, ku mjedisi dhe cilësia nuk janë thjesht parametra ose politika sektoriale, por boshtet kryesore dhe bazat e një plani (programi) të ri të zhvillimit alternativ të qëndrueshëm të ekonomisë së një vendi.

Problemi shtrohet për një zhvillim të qëndrueshëm për sot dhe për nesër. Sipas raportit Brundtland, „Zhvillimi i qëndrueshëm është një zhvillim që plotëson nevojat e të tashmes pa bërë kompromise me aftësinë e gjeneratave të ardhme për të plotësuar nevojat e tyre”.

Cilat ndryshime janë të nevojshme?

„Zhvillimi i gjelbër” duhet konsideruar si një model zhvillim ekonomik që respekton mjedisin dhe që e konsideron atë si resurs zhvillimi. E rëndësishme dhe e domosdoshme është të konsiderohen disa çështje si:

a. Klima dhe energjia.

b. Ekonomi dhe kursim në resurset natyrale dhe infrastrukturën e gjelbër (Administrim i mirë i resurseve ujore, i zonave të mbrojtura, pyjeve, liqeneve, lumenjve etj, mbrojtje e ambientit detar, inventar të saktë të tyre, politika tatimore lehtësuese për bizneset e lidhura me të).

Më konkretisht për këtë çështje synohet:

1. Hartimi dhe zbatimi i politikave ekonomike që të ndihmojnë orientimin drejt kalimit në „zhvillimin e gjelbër” (Shteti duhet të ketë rol të rëndësishëm në stadet e para të zbatimit të „modelit të zhvillimit ekonomik të gjelbër”, duke ju dhënë institucioneve të tij funksione në zbatim të këtij modeli);

2. Inventarizim i pasurive natyrore të vendit sipas rajoneve gjeografike;

3. Politika tatimore do të jetë më e lehtë ndaj bizneseve që përdorin teknologji miqësore ndaj ambientit;

4. Përparësi do t'i jepet kërkimit shkencor për përdorimin sa më të mirë të resurseve natyrore;

5. Krijimin e një „arke shtetërore” për investim në ruajtjen dhe rritjen e cilësisë së ambientit;

6. Ngritja e institucioneve që duhet të „lëvizin drejt ekonomisë së gjelbër” dhe rritja e angazhimit për pjesëmarrje të fuqishme të administratës vendore për të marrë pjesë në zhvendosjen drejt zhvillimit ekonomik të gjelbër;

7. Investim në kërkimin shkencor dhe teknologjitë e reja (promovimi i teknologjive që qëllim kanë prodhimin industrial dhe shërbimet të bazuara te mbrojtja e mjedisit dhe te shfrytëzimi alternativ dhe i qëndrueshëm i tij);

8. Vendosjen e politikave bujqësore në qendër të zhvillimit të gjelbër (Konvertimi i bujqësisë në bujqësi organike);

9. Investim në turizëm dhe përmirësim të cilësisë së produkteve të tij, duke lënë pas amatorizmin në këtë fushë.

Pranimi dhe familjarizimi me „zhvillimin e ekonomisë së gjelbër” duhet të jetë dhe një përjasje e zhvillimeve të ardhshme edhe për ekonominë e të dy vendeve tona, i cili duke qenë shumë dimensional duhet të përfshijë një koncept të ri të zhvillimit të ardhshëm e perspektiv të kësaj pasurie natyrore, ekonomike, ekologjike e psiko dhe të zhvillimit social.

Por, krahas arritjeve të shënuara në këtë drejtim në të dy vendet tona, aktivitetet e pa kontrolluara gjatë periudhës së tranzicionit si: prerja masive e pyjeve, gërryerja e shtratit të lumenjve, shpërdorimi i tokës bujqësore, emetimi i pa kontrolluar i mbeturinave në sipërfaqe, lumenj e liqene, ka bërë që të kemi erozion masiv të tokës, rrëshqitje, përmbytje, gërryerje dhe devijime deri të hapësirave bregdetare.

Këtu nuk bën përjashtim edhe qëndrimi i mbajtur ndaj trajtimit të çështjes së Liqenit të Shkodrës dhe të gjithë jetës që zhvillohet rreth tij.

Kësisoj, është e domosdoshme që edhe në këtë drejtim të dilet nga skemat spon-tane, të rastit dhe të shkëputura, dhe të vepohet me programe konkrete e të qarta për të arritur një model të suksesshëm zhvillimi.

## ZHVILLIM I SHKURTËR HISTORIK EKONOMIK I „ZONËS SË LIQENIT TË SHKODRËS”

Të gjitha teoritë dhe pikëpamjet ekonomike e ekologjike dhe sidomos sot, ato të zhvillimit të ekonomisë së gjelbër, kanë pranuar dhe pranojnë se „çdo qendër e banuar, e cila është e vendosur pranë një burimi ujor, është e prirur për një zhvillim

më të madh sesa qendrat e tjera që janë në zona më në brendësi të vendeve”. Nisur nga një pranim i tillë teorik janë përshtatur dhe zhvillimet (shpesh të suksesshme) e vendbanimeve, në varësi të afërsisë me burimet ujore, oqean, det, liqen apo lumenj.

Por, për fat të keq, me gjithë përpjekjet e bëra në shekuj, nuk mund të thuhet e njëjta gjë dhe për Liqenin e Shkodrës dhe për shfrytëzimin e tij në dobi të banorëve, zonave dhe shteteve tona që e disponojnë dhe janë pranë tij. Shpesh banorët e zonave që rrethojnë këtë liqen kanë ndenjur larg tij (ujit), duke mos krijuar një lidhje të qëndrueshme me të. Veprimtaria më e qëndrueshme ka qenë peshkimi edhe ky jo i organizuar, por në baza të vogla. Janë të shumta arsyet dhe faktorët historikë, ekonomikë, ekologjikë, socialë e shoqërorë, që na bëjnë të gjykojmë dhe të priremi drejt një modeli të ardhshëm të suksesshëm zhvillimi të Liqenit të Shkodrës, banorëve, zonave dhe vendeve tona që e zotërojnë këtë pasuri. Kësisoj, është e domosdoshme që edhe në këtë drejtim të dilet nga skemat spontane, të rastit dhe të shkëputura dhe të synohet drejt një modeli të suksesshëm të zhvillimit të tij bazuar në një vizion të qartë.

Studimet e kryera në kohë të ndryshme na kanë ofruar dhe na ofrojnë informacione të shumta mbi të cilat janë arritur shumë konkluzione dhe mund të na shërbejnë edhe sot si një bazë e rëndësishme për qëllimet tona të zhvillimit të ardhshëm.

Si çdo fenomen, problem, në histori, edhe çështja e Liqenit të Shkodrës, e parë në këndvështrimin historik të zhvillimit të tij, ka njohur periudhat e lulëzimit dhe rënies.

Në një pjesë të mirë të historisë së vet, ky liqen, është kthyer në burim mirëqenie dhe zhvillimi tregtar, si një urë komunikimi dhe lidhjeje tepër e fuqishme në mes zonave, territoreve të ndryshme brenda e jashtë vendit.

Një pjesë tjetër, siç kanë qenë dhe 60 vitet e fundit, për shumë arsye, ai nuk arriti të kthehet në një model të suksesshëm zhvillimi dhe më tepër u shndërrua në një bashkëshoqërues i thjeshtë i jetesës së këtyre zonave, pa ndonjë ndikim të dukshëm në zhvillimin ekonomik e social të tyre.

## A. EKONOMIA NË PELLGUN UJËMBLEDHËS TË LIQENIT TË SHKODRËS NË PJSËN SHQIPTARE

Ndër shekuj Shkodra ka luajtur një rol të rëndësishëm ekonomik, urban dhe kulturor në Shqipëri, për shkak të pozicionit të saj si një urë komunikimi me vendet e Europës jugore dhe lindore, me burimet natyrore, shkallën e lartë të civilizimit dhe një ekonomi tradicionale të konsoliduar. Të gjitha këto karakteristika përbëjnë një bazë të mirë për zhvillimin e sotëm ekonomik të Shkodrës.

Informacionet dëshmojnë se, që para shek. XVIII, Shkodra është përfshirë në një zhvillim ekonomik e tregtar të rëndësishëm për nivelin e zhvillimit të asaj kohe (kujtojmë këtu: prerjen e monedhës në vitin 230 p. k. me iniciale që dëshmojnë emrin e qytetit, Scodrinon; në shek. XIII, rrugët tregtare të rëndësishme drejt bregut Dalmat, nga Veriu, dhe nëpërmjet luginës së Drinit për në Kosovë, nga Lindja dhe lëvizjen e mallrave në to, etj; në 1718 janë hapur në Shkodër agjencitë e para konsullore; në 1730 krijohet Dhoma e Tregtisë, etj.).

Në shekujt XVIII-XIX deri në Luftën e Dytë Botërore Shkodra ishte një qendër e rëndësishme tregtare, e pozicionuar në rrugën antike të tregtisë ndërmjet detit Mesdhe dhe Kosovës në brendësi, duke konsoliduar pozicionin e tij tregtar me vende të ndryshme të Europës, me një port të brendshëm, me 2500 dyqane në Pazar dhe 80 lloje zejesh. Qyteti arrin në 50.000 banorë dhe bëhet qendër Vilajeti.

Në vitin 1867 qyteti ka institucionet tregtare të kohës, gjykatë, drejtori postare, dogane. Në vitet 1924 deri më 1939 pati një zhvillim industrial me fabrika të vogla kryesisht në industrinë ushqimore dhe të çimentos. Në vitin 1939 kishte rreth 70 fabrika të tilla. Gjatë kësaj periudhe të monarkisë qyteti ka një administrim europian, me institucione të rregullta, dhe kryhen një varg reformash progresiste. Në vitin 1939 Shqipëria u pushtua nga ushtritë fashiste. Në vitin 1945 u vendos diktatura komuniste.

*Para vitit 1990* Shkodra, vuajti për 45 vjet nga represioni komunist që donte ta privonte qytetin nga prirjet e tij demokratike dhe kulturore, nga marrëdhëniet me botën dhe nga ekonomia e tij tradicionale.

Megjithatë, Shkodra ishte një nga qendrat kryesore industriale dhe ekonomike të Shqipërisë dhe kishte punonjës shumë të specializuar në disa degë të lidhura me përpunimin e lëndës së parë dhe të bazuara në teknikat e mëparshme tradicionale.

Dy sipërmarrje artizanale mjaft të rëndësishme dhe shumë të njohura në Shqipëri kanë qenë Ndërmarrja e Prodhimeve Artistike si dhe ajo e përpunimit të kashtës dhe kallamit.

Si rezultat i reformave në ekonominë e tregut pas viteve '90, struktura e ekonomisë së Shkodrës pësoi ndryshime të mëdha, kështu 9/10 e ndërmarrjeve shtetërore u privatizuan. Përpunimi i ushqimeve, përpunimi i drurit dhe industria e prodhimeve artizanale, të cilët ishin ndër prodhuesit më të mëdhenj të kohës, u shpërbënë në një numër të madh ndërmarrjesh të vogla (SME).


Industria e përpunimit të duhanit dhe industria e prodhimit të cigareve u shkatërruan pothuajse plotësisht. Paaftësia për të investuar në rinovimin teknologjik dhe konkurrenca e produkteve të importit solli falimentimin e tyre.

## **B. GJENDJA AKTUALE E ZHVILLIMIT SOCIAL EKONOMIK TË „ZONËS SË LIQENIT TË SHKODRËS”**


### *Popullsia në pellgun ujëmbledhës të Liqenit të Shkodrës*

Numri i banorëve në pellgun ujëmbledhës të Liqenit të Shkodrës është afërsisht 500.000. Pjesa më e madhe e popullsisë i takon rajonit të Shkodrës, ndërsa në Mal të Zi i takon Podgoricës, Nikshiqit, Cetinjës dhe Danilovgradit. Rritja aktuale e popullsisë në Mal të Zi është 0.03% dhe jetëgjatësia është 73 vjeç. Në Shqipëri është përkatësisht 0.6% dhe 74 vjeç. Pjesa e popullsisë që jeton nën limitin e varfërisë në të dy vendet është rreth 30%.

Në pjesën shqiptare të liqenit ndodhen rreth 20 fshatra dhe 2 bashki, ku Shkodra është qyteti kryesor i zonës. Nga këto, 10 fshatra me 300–1000 banorë janë të vendosur më pranë liqenit.



Grafiku 1. Struktura e popullatës së vendbanimeve urbane dhe rurale në zonën e Liqenit të Shkodrës në Shqipëri



Grafiku 2. Struktura e popullatës së vendbanimeve urbane dhe rurale brenda Parkut Kombëtar të Liqenit të Shkodrës në Malin e Zi

Pasqyra 1. Bashkitë dhe komunat në zonën liqenore

Bashkitë dhe komunat në zonën liqenore					
Nr.	Bashki/ Komuna	Sipërfaqe (km <sup>2</sup> )	Popullsia	Nr. familje	Nr. fshatra
1	Shkodra	30	109,632	34,682	–
2	Koplik	9.30	12,900	3,040	–
3	Rrethina	47.05	16,242	5,762	10
4	Gruemirë	113.70	15,130	3,010	15
5	Kastrat	128.70	12,740	2,530	12
6	Qendër	46.72	4,800	1,260	8
	Total	375.47	171,444	50,284	45

Burimi: INSTAT

Shkodra është qendra më e zhvilluar e rajonit dhe bashkia më e madhe e zonës liqenore. Ajo është e pozicionuar në pjesën jug-lindore të liqenit. Ka një sipërfaqe prej 30 km<sup>2</sup>, lartësi mbi nivelin e detit 9–10 m ose 3–4 m mbi nivelin e liqenit. Ka një

popullsi prej 110.000 banorësh dhe 34.682 familjesh. Popullsia e qytetit të Shkodrës përbën 32% të numrit total të popullsisë së Rajonit të Shkodrës (Qarku Shkodër) dhe 45% të popullsisë të Rrethit Shkodër.

*Biznesi në Shkodër* numëron rreth 6.270 aktivitete në fusha të ndryshme të prodhimit, bujqësi dhe agrobiznes, peshkim, ndërtim, industri, turizëm-hoteleri-kafe restorante, transport dhe shërbime të ndryshme

## PERSPEKTIVA E ZHVILLIMIT

Liqeni i Shkodrës kohët e fundit ka qenë në qendër të vëmendjes në bashkëpunimin mes Shqipërisë dhe Malit të Zi në aspektin mjedisor. Projekte të ndryshme janë zbatuar nga OJF-të lokale, organizata ndërkombëtare, institucione qeveritare etj. në të dy vendet. Këto projekte kanë luajtur një rol të rëndësishëm në rritjen e njohurive mbi Liqenin e Shkodrës dhe bashkëpunimin midis dy vendeve, jo vetëm në aspektin mjedisor, por edhe atë shkencor, kulturor, socio-ekonomik dhe zhvillimit të qëndrueshëm.

Nisur nga gjendja aktuale dhe mendimet e vyera që po paraqiten në këtë konferencë mendoj se është koha për një vizion të ri dhe një model të qartë të zhvillimit të zonës së Liqenit të Shkodrës duke synuar: Shndërrimin e tij në një model të suksesshëm zhvillimi përmes konceptimit dhe lidhjes së tij, si një model zhvillimi të përbashkët, ndërveprimit ekonomik dhe ekologjik, turistik-pushueso-atraktiv dhe infrastrukturor-transporti, peshkimi, biznesi, shërbimesh sociale, etj.

Për këtë është e domosdoshme:

*1. Hartimi i një strategjie të përbashkët projektesh dhe të zhvillimit ekonomik jo për të ndarë zonat e influencës, por për të përcaktuar prioritetet dhe bashkëpunimin.*

Sot ekziston dhe po punohet me përparësi në një strategji për zhvillimin e Liqenit të Shkodrës. Qëllimi i Planit Strategjik të Veprimit (PSV) për liqenin e Shkodrës është të ndihmojë institucionet qeveritare dhe grupe të tjera të interesuara/institucione në Mal të Zi dhe Shqipëri, të përcaktojnë aktivitetet dhe projektet në nivel lokal, kombëtar ose bilateral, duke synuar përmirësimin e menaxhimit mjedisor dhe përdorimin e qëndrueshëm ekonomik të burimeve natyrore të Liqenit të Shkodrës dhe zonave përreth tij.

Megjithatë, strategjitë e zhvillimit dypalësh, duhet të fokusohen kryesisht në projekte konkrete dhe me financimet e duhura për projektet që plotësojnë njëri tjetrin dhe nuk krijojnë mbivendosje qoftë për shkak të paqartësive politike, por edhe për shkak të pakënaqësive lokale, për këtë apo atë projekt, për një model apo për një tjetër. Kapërcimi i këtyre problemeve në një kohë sa më të afërt do të ishte pozitive për zhvillim të shpejtë.

*2. Aktivitet ekonomik i orientuar vetëm në shërbim të liqenit përmes zhvillimit të turizmit, aktiviteteve të biznesit plotësues dhe mbështetës të tij, peshkimit, transportit, etj.*

Zhvillimi dhe bashkëpunimi ekonomik dypalësh, rajonal e europian dhe lëvizja e lire e popullsisë nxjerr më në pah rigjallërimin e këtij aksi jo vetëm për qëllime tregtare por edhe për qëllime turistike.

Aktualisht, kapaciteti strehues për turistë i qytetit të Shkodrës është 12 hotele dhe 350 shtretër. Me 3 pikat e kufirit me Malin e Zi (Muriqan 13 km nga Shkodra, Hani-Hotit 30 km nga Shkodra dhe një pikë kalimi liqenore), Shkodra përfshihet në paketa të ndryshme turistike, kryesisht ato që mbulojnë udhëtimet një ditore për turistët që vizitojnë Malin e Zi dhe Kroacinë.

Alpet e Shqipërisë, janë konsideruar gjithmonë si një pikë për t'u zbuluar nga turistët, duke rritur interesin e vizitorëve lokalë dhe ndërkombëtarë të cilët ndalojnë netëve në Shkodër dhe organizojnë udhëtime 1–3 ditore për në Vermosh, Theth ose Razëm, ku strehohen nga vendasit në bujtina private.

Liqeni është përdorur tradicionalisht nga vendasit për pushime verore, veçanërisht gjatë fundjavave. Baret dhe restorantet (rreth 22 në bregun perëndimor) përgjatë bregut të liqenit në vijën Shiroka-Zogaj dhe Sterbeq përbëjnë një tjetër tërheqje për vendasit, si dhe një ofertë për turistët. Zogaj dhe Shiroka janë lokalitetet e përdorura nga shkodranët jo vetëm për turizmin kurativ dhe familjar, duke përdorur shtëpitë private si vend qëndrimi, por edhe për turizmin kulturor me traditat e artizanatit dhe peshkimit. Krahas zhvillimit ekonomik, duhet pasur parasysh mirëmenaxhimi i mbetjeve të këtyre aktiviteteve. Megjithatë, sporti ujqor, turizmi natyror dhe kampingu akoma nuk ofrohen si potencial turistik.

### 3. Shfrytëzimi dhe fuqizimi i të gjithë burimeve në dispozicion.

PESHKIMI. Peshkimi ka qenë i përqendruar më tepër në disa fshatra të bregut të Liqenit të Shkodrës dhe Lumit Buna.

Peshkimi në liqen ndahet në tre kategori: për qëllim tregtar, përdorim i vogël shtëpiak dhe peshkimi sportiv. Numri i personave që e praktikojnë peshkimin si sport është i kufizuar. Nuk ka ndonjë mënyrë të organizuar të shitjes së peshkut. Aktualisht peshkimi është një aktivitet për më pak se 15% të familjeve që jetojnë në brigjet e liqenit. Kjo vjen si rezultat i rënies së rezervave peshkore, që ka sjellë edhe rënie të të ardhurave dhe si rrjedhojë ka bërë që komuniteti lokal të gjejë mënyra të tjera jetese të tilla si shitja me pakicë, bujqësia, industria agrare, blegtoria, migrimi etj. Organizata e Menaxhimit të Peshkimit (OMP) numëron 195 subjekte legale të liçensuar (grupe) me rreth 450 peshkatarë. Fshati Zogaj është i vetmi që mbështetet në peshkim si mënyrë e jetese, ndërkohë që Shiroka është pjesërisht i varur nga ky aktivitet

Llojet tradicionale që peshkohen në Shqipëri janë krapi (*Cyprinus carpio*), gjuca (*Alburnus alburnus alborella*), ngjala (*Anguilla anguilla*), qefulli (*Mugil cephalus*) dhe kubla (*Allosa fallax*). Dhjetëvjeçarët e fundit vihet re një rritje e shpejtë e fuqjes së peshkut nga jashtë, si krapi prusian (*Carassius auratus gibelio*) dhe sharmakut (*Perca fluviatilis*). Krapi konsiderohet si „mbreti i liqenit” dhe një „simbol” i peshkimit nga vendasit në Shkodër.

Gjatë dy dekadave të fundit peshkimi i jashtëligjshëm në liqen është rritur. Peshkohet edhe në periudhën e lëshimit të vezëve, duke përdorur edhe mjete ilegale peshkimi, duke shkaktuar dëmtim të parikuperueshëm të faunës së Liqenit të Shkodrës. Përveç kësaj, një problem serioz mbetet konkurrimi i pabarabartë (i pandershëm) i peshkatarëve të ligjshëm me ata të jashtëligjshëm. Në 1990 numëroheshin vetëm 100 peshkatarë, ndërkohë që në vitin 2005 numëroheshin rreth 450 të li-



gjshëm dhe një numër i madh (i pa llogaritur saktësisht) peshkatarësh të jashtëligjshëm. Peshkatarët e licencuar herë pas here i kanë drejtuar apel shtetit për mbështetje në ndalimin e dëmtimit të burimeve të peshkut nga peshkatarët e jashtëligjshëm.

*AKUAKULTURA* është pothuajse e pazhvilluar. Peshkimi në liqen është i organizuar edhe nga Organizata e Menaxhimit të Peshkimit (OMP), krijuar nga një Projekt i Bankës Botërore në mbështetje të peshkimit. Ky projekt i ka siguruar kësaj organizate dy ndërtesa të reja në Shirokë dhe Zogaj.

Menaxhimi jo i mirë i mbetjeve të ngurta dhe ujërave të zeza konsiderohet një faktor pengues për zhvillimin e turizmit përgjatë bregut të liqenit.

Përsa i përket fshatrave dhe pjesës lindore të liqenit, ka pak mundësi akomodimi dhe nuk ka organizim të ofertave turistike. Kopluku, si qendra kryesore urbane në bregun lindor, me mjaft shtëpi të reja cilësore, mund të jetë një qendër, e cila të ofrojë akomodim privat dhe familjar për vizitorët, të cilët dëshirojnë të shijojnë turizmin natyror dhe atë rural pranë liqenit.

### **PESHKIMI (CATCH AND RELEASE)**

Nuk praktikohet pothuajse aspak në Liqenin e Shkodrës megjithëse është një sport që do të mund të përkrahet gjithmonë duke ruajtur periudhat e caktuara dhe duke rritur kontrollin e fortë për abuzuesit dhe ndotësit e mjedisit.

### **LUNDRIMI**

Duhet të pranojmë se jemi shumë larg në këtë drejtim dhe sidomos kur flitet për një sipërfaqe kaq të madhe të lundrueshme.

Nxitja dhe lehtësimi i lundrimit familjar me një program të qartë është një tjetër pikë e strategjisë. Në çdo sipërfaqe të lundrueshme sheh lulëzim të këtij lundrimi, gjë që nuk ndodh në Liqenin e Shkodrës

Dy veprimtaritë kryesore në përdorimin e tokës në zonën e liqenit, janë bujqësia dhe blegtoria.

### **BUJQËSIA**

Në rajonin e Shkodrës toka bujqësore zë afërsisht 13%, ndërkohë që pyjet, kullotat dhe tokat e braktisura zënë afërsisht 64%.

Niveli ekonomik nuk i lejon fermerët që të sigurojnë teknologjinë e nevojshme për të mbështetur zhvillimin e bujqësisë në zonë. Kultivimi i perimeve është i përhapur në gjithë zonën e banimit, veçanërisht për shitje. Drurët frutorë dhe sidomos vreshtaria janë zhvilluar këto 10 vitet e fundit kryesisht për qëllime industriale.

Aktualisht, bujqësia ka mjaft probleme me prodhimin, shitjet, zhvillimin e fermave dhe infrastrukturën. Një dëm të madh në tokat bujqësore rreth liqenit shkaktojnë dhe pesticidet e përdorura që kanë një impakt negativ të mëtejshëm në ujin dhe jetën e liqenit. Punimet mbi baza individuale dhe rralle si një punë në grup, duke pasur një shije të hidhur nga kolektivizimi i periudhës së shkuar. Përveç kësaj, du-

ke qenë në shumë raste një tokë pa pronësi të deklaruar, ajo nuk mund as të jepet me qera as të shitet në rrugë ligjore.

## BLEGTORIA

Blegtoria ka një zhvillim më të madh si rezultat i ekzistencës së kullotave, kushteve klimatike dhe prodhimtarisë së lartë dhe të shpejtë të siguruar nga burimet natyrore. Blegtoria zë 50% të prodhimit total bujqësor. Administrimi i kullotave është nën ngarkim të Drejtorisë Rajonale të Pyjeve dhe Kullotave. Megjithatë këto zona janë nën administrimin shtetëror nuk vërehet asnjë aktivitet menaxhues.

Destinacioni kryesor i prodhimeve blegtorale janë tregu dhe përmbushja e nevojave familjare si qumështi, djathi, mishi etj. Fshatarët i shesin vetë prodhimet e tyre, por në disa raste ekzistojnë gjithashtu kompani të grumbullimit të produkteve, siç është ajo e produkteve të qumështit.

Pasqyra 2. Prodhimi blegtorial

Prodhimi blegtorial			
Rrethi	Qumësht/koke	Total qumësht /vit	Mish/vit
Shkodra	2900 kg	85747 ton	10115 ton
Malësia e Madhe	1363 kg	17349 ton	3068 ton

*Burimi:* Drejtoria Rajonale e Bujqësisë dhe Ushqimit

## AGROINDUSTRIA

Agro-industria është një degë e ekonomisë gjithmonë në zhvillim. Agro-industritë janë të privatizuara dhe kanë një teknologji të përparuar. Të gjitha këto industri punojnë me më pak se gjysmën e kapacitetit të tyre për shkak të mungesës së lëndës së parë dhe krizës së tregut. Vështirësitë e krizës së tregut nuk kanë të bëjnë vetëm me infrastrukturën, por edhe me cilësinë dhe çmimin e produkteve. Çmimet e arsyeshme dhe cilësia e lartë e produkteve të importuara e kanë bërë të vështirë ekzistencën e një aksesit të plotë të tregut për agro-industrinë vendase dhe prodhimet e saj. Numri i punonjësve në industrinë agrare është rreth 615. Pjesa më e madhe e tyre punojnë me prodhimet e mishit, bukës dhe djathit.

Pasqyra 3. Kapacitetet Agro-industriale

Kapacitetet Agro-industriale		
Fabrikat e përpunimit	Numri	Kapaciteti
Mish	3	2.200 kg/ditë
Djathë, qumësht, kos	70	1.300 ton/ ditë
Bukë	60	80.000 kg/ ditë
Fruta/perime	1	30.000 kg/ ditë
Pije	5	1.600 hl/vit
Vaj ulliri	1	400 kg/orë

*Burimi:* Drejtoria Rajonale e Bujqësisë dhe Ushqimit.

4. *Zhvillimi infrastrukturor jo vetëm në afërsi të qytetit por në të gjithë hapësirën ku shtrihet liqeni në të dy anët e kufirit*

Për të realizuar një model të zhvillimit ekonomik bashkëkohor të Liqenit të Shkodrës nuk mund të mos fokusohemi fuqishëm në projektet ambicioze në infrastrukturën e tij. Kjo kërkon qartësi në projektet e nevojshme infrastrukturore të disa llojeve të rrugëve rurale, turistike, kombëtare pse jo dhe ndërkombëtare, kanalizime, kolektorë, ujësjellës, projekte dhe investime në ruajtjen, zhvillimin dhe ripërtëritjen e florës dhe faunës së liqenit, ambienteve argëtuese, të pushimit dhe sportive, etj.

Pa dyshim që çështja e financimit të këtyre projekteve është një moment i rëndësishëm dhe për këtë duhet të shfrytëzohen: financimet e përbashkëta të të dy qeverive, nga financimet e përbashkëta të fondeve të qeverisjes vendore, nga financimi i projekteve, nga donatorë të ndryshëm, të BE, BB dhe institucioneve të tjera.

5. *Realizimi përmes një bashkëpunimi të ngushtë publik-privat*

Ky është një aksion tepër i rëndësishëm pa të cilin suksesi i një modeli zhvillimi për Liqenin e Shkodrës do të ishte i pamundur. Prandaj krijimi i të gjithë elementëve të domosdoshëm dhe i lehtësive për funksionimin e këtij bashkëpunimi, është dhe duhet të jetë gjithnjë i mirëpritur.

6. *Përmirësimi, bashkëpunimi dhe harmonizimi i legjislacionit në mbrojtje, ndihmë dhe zhvillim të Liqenit të Shkodrës. Megjithë hapat e bërë në këtë drejtim është e domosdoshme përmirësimi i mëtejshëm nxjerrja e akteve të nevojshme nënligjore dhe sidomos zbatimi i tyre.*

7. *Ngritja e institucioneve të nevojshme (pse jo dhe të përbashkëta) për mirëfunksionimin e veprimtarive dhe të gjithë llojeve të aktiviteteve ekonomike e sociale në Liqenin e Shkodrës, do të ishte një ndihmesë tjetër në këtë çështje.*

## PËRFUNDIME

Duke shfrytëzuar mendimet e dhëna në këtë konferencë dhe konferenca të tjera, si dhe gjithë studimet e bëra për Liqenin e Shkodrës, është koha për të kryer e zbatuar veprime dhe nisma konkrete të përbashkëta të zhvillimit të gjithanshëm të tij, të mirëmenaxhimit, veçanërisht të bazuara në modelet e ofruara të zhvillimit ekonomik të gjelbër, si një model i suksesshëm dhe i së ardhmes.

## REFERENCAT

### A-Botime:

Dennis, J. *The living Great Lakes: searching for the heart of the inland seas.*

Pano, N, 2008. *Pasuritë Ujore të Shqipërisë*, Tiranë

Bushati, H. *Shkodra dhe motet.*

Hodaj, N., *Ekonomia e Gjelbër dhe modeli ekonomik*, Gazeta „Shqip”.

### B-Studime:

– Technical Report on bathymetric and geodetic survey of Scadar Lake basin, (Hidro-meteorological Institute of Montenegro)

- Ministria e Mjedisit, Pyjeve dhe Administrimit të Ujërave të RSH.
- Ministria Planifikimit Hapësinor dhe Mjedisit të Malit të Zi. (Projektit Menaxhimi i Integruar i Ekosistemit të Liqenit të Shkodrës. Planin Strategjik të Veprimit)

***C-Informacione e të dhëna:***

- INSTAT
- Banka e Shqipërisë
- Ministria e Bujqësisë dhe Ushqimit e RSH.
- Ministria e Financave e RSH
- Ministria e Brendshme e RSH
- Bashkia Shkodër, [www.shkodra.gov.al](http://www.shkodra.gov.al)